



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

Nr. 2301 Prot.

Tiranë, më 18.12.2025

URDHËR

Nr. 153, Datë 18.12.2025

PËR

**SHPLLJEN E KONKURISIT PËR PËRZGJEDHJEN E LOGOS FITUESE NË
KUADËR TË 60-VJETORIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Mbështetur në nenin 39, pika 12 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 27, pika 2 të Statutit të Universitetit të Arteve, me rastin e 60 vjetorit të formimit të Universitetit të Arteve,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e konkursit për përzgjedhjen e logos zyrtare në kuadër të 60-vjetorit të Universitetit të Arteve, e cila do të përdoret në të gjitha materialet propagandistike që do të përgatiten dhe do të shoqërojnë aktivitetet e 60 vjetorit si dhe në të gjitha shkresat e qarkullimit të brendshëm përgjatë vitit kalendarik 2026.
2. Konkursi do të jetë i hapur për studentët e Fakultetit të Arteve të Bukura dhe afati përfundimtar për aplikim do të jetë data 23 janar 2026, ora 14:00.
3. Shpallja e logos fituese do të bëhet deri më datë 30 janar 2026, ora 14:00.
4. Organizimi dhe administrimi i procesit të konkursit, duke përfshirë përcaktimin e kriterëve, udhëzimeve apo specifikimeve teknike në lidhje me logon, adresës për dorëzimin e aplikimeve, ngritjes së Komisionit të Vlerësimit do të bëhet nga Fakulteti i Arteve të Bukura.
5. Me përzgjedhjen e logos fituese, të gjitha të drejtat do t’i takojnë Universitetit të Arteve.
6. Ngarkohet Fakulteti i Arteve të Bukura për zbatimin e këtij urdhri si dhe Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore & ISJ P-A për publikimin dhe njoftimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Eran Bakalli



